# PASQYRAT FINANCIARE

## Sipas SKK 15

**"Per Kontabilitetin dhe Raportimet Financiare te Mikronjesive Ekonomike"**

***Të dhëna identifikuese***

**- Emri** **MAKAPAKA EXCHANGE sh.p.k.**

- **NIPT** **L 21408005 P**

- **Adresa** **Rruga Bajram Curri, Pall. 1 Maji, Shk.4, Tirane**

***Të dhëna të tjera***

- **Monedha** LEK

- **Rrumbullakimi** __________

- **Periudha Kontabël**
*Nga 08.02.2013 Deri 31.12.2013*

- **Data e plotësimit të PF** 05 02.2014

# MAKAPAKA EXCHANGE

## AKTIVET

| Nr. Ref. | A K T I V E T | Viti Ushtrimor | |
|---|---|---|---|
| | | 31 Dhjetor 2013 | 31 Dhjetor 2012 |
| **I** | **Aktive Afatshkurtra** | **2,756,333.39** | **2,306,447.34** |
| **1** | **Mjetet Monetare** | **2,756,333.39** | **2,289,851.97** |
| **2** | **Derivate dhe Aktive Financiare te mbajtur per tregtim** | - | - |
| a) | Derivatet | - | - |
| | ***Totali 2*** | - | - |
| **3** | **Aktive te tjera Financiare afatshkurter** | **-** | **16,595.37** |
| a) | Llogari kerkesa te arketueshme | - | - |
| b) | Llogari kerkesa te tjera te arketueshme | - | 16,595.37 |
| c) | Instrumente te tjera borxhi | | |
| | ***Totali 3*** | ***-*** | ***16,595.37*** |
| **4** | **Inventari** | **-** | **-** |
| a) | Lendet e para | - | - |
| b) | Prodhimi ne proces | - | - |
| c) | Produkte te gatshme | - | - |
| d) | Mallra per rishitje | | |
| e) | Parapagesat per furnizime | | |
| | ***Totali 4*** | ***-*** | ***-*** |
| | ***Total i Aktiveve Afatshkurtra*** | ***2,756,333.39*** | ***2,306,447.34*** |
| **II** | **Aktive Afatgjata** | **138,459.00** | **173,073.61** |
| **5** | **Aktive Afatgjata Materiale** | **138,459.00** | **173,073.61** |
| a) | Toka | | |
| b) | Ndertesa (neto) Ndertime ne Proces | - | - |
| c) | Makineri dhe pajisje (neto) | 138,459.00 | 173,073.61 |
| ç) | Akitive te tjera afatgjata materiele (neto) | - | - |
| | ***Totali 2*** | ***138,459.00*** | ***173,073.61*** |
| **6** | **Aktive te tjera afatgjata (ne proces)** | | |
| | ***Totali i Aktiveve Afatgjata*** | ***138,459.00*** | ***173,073.61*** |
| | **TOTALI AKTIVEVE** | **2,894,792.39** | **2,479,520.95** |

# MAKAPAKA EXCHANGE

## DETYRIMET DHE KAPITALI

| Nr. Ref. | PASIVET DHE KAPITALI | Viti Ushtrimor | |
|---|---|---|---|
| | | 31 Dhjetor 2013 | 31 Dhjetor 2012 |
| **I** | **Pasivet Afatshkurta** | **33,646.96** | **35,877.00** |
| 1 | **Huamarrjet** | **-** | **-** |
| a) | Huate dhe obligacionet afatshkurtra | - | - |
| | ***Totali 2*** | **-** | **-** |
| 2 | **Detyrimet Tregtare** | **33,646.96** | **35,877.00** |
| a) | Te pagueshme ndaj furnitoreve | | |
| b) | Te pagueshme ndaj punonjesve | | - |
| c) | Detyrimet tatimore | 33,646.96 | 35,877.00 |
| ç) | Parapagimet e arketueshme | | - |
| | ***Totali 3*** | ***33,646.96*** | ***35,877.00*** |
| | **Pasive Totale Afatshkurtra** | **33,646.96** | **35,877.00** |
| **II** | **Pasivet Afatgjata** | **-** | **-** |
| 1 | **Huate afatgjata** | **-** | **-** |
| a) | Hua, bono dhe detyrime nga qeraja financiare | | |
| | **Pasive Totale Afatgjata** | **-** | **-** |
| | **Pasive Totale** | **33,646.96** | **35,877.00** |
| **III** | **Kapitali** | **2,861,145.25** | **2,443,643.94** |
| 1 | **Kapitali i Pronarit** | 2,500,000.00 | 2,500,000.00 |
| 2 | **Fitimi (humbje) e vitit financiar** | 361,145.25 | (56,356.06) |
| 3 | **Terheqjet e Pronarit** | | |
| | **Totali i Kapitalit** | **2,861,145.25** | **2,443,643.94** |
| | **TOTALI I PASIVEVE DHE KAPITALIT** | **2,894,792.21** | **2,479,520.94** |

# MAKAPAKA EXCHANGE

## PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE
## (Bazuar në klasifikimin e Shpenzimeve sipas Natyrës)

| Nr. Ref. | Pershkrimi | Viti Ushtrimor | |
|---|---|---|---|
| | | 31 Dhjetor 2013 | 31 Dhjetor 2012 |
| **I** | **TE ARDHURAT** | **1,703,846.07** | **604,577.30** |
| 1 | Shitjet neto | 1,703,846.07 | 604,577.30 |
| 2 | Të ardhura të tjera | | |
| **II** | **SHPENZIMET** | **(1,238,111.80)** | **(654,611.72)** |
| 1 | Shpenzimet per materiale | - | - |
| | *Inventari ne Celje | | |
| | *Shpenzime per mallrat | - | |
| | *Inventari ne fund te vitit | | |
| 2 | Shpenzime Personeli | (901,086.00) | (523,521.00) |
| | * Shpenzimet Pagat | (858,000.00) | (513,000.00) |
| | *Shpenzime Sigurimet shoq.e.shend | (43,086.00) | (10,521.00) |
| | *Shpenzime per Honorare | - | - |
| *3* | Amortizimet dhe zhvlerësimet | (34,614.80) | |
| 4 | Shpenzime të tjera | (303,653.90) | (24,744.15) |
| 5 | Të ardhurat dhe shpenzimet financiare | ***1,242.90*** | ***(106,346.57)*** |
| **A** | ***Fitimi (humbja) para tatimit (I- II)*** | ***465,734.27*** | ***(50,034.42)*** |
| 6 | Shpenzimet e tatimit mbi fitimin | **(48,232.96)** | **(6,321.64)** |
| | | | |
| **B** | **Fitmi (humbja) neto e vitit financiar (A-6)** | **417,501.31** | **(56,356.06)** |

# MAKAPAKA EXCHANGE

## PASQYRA E FLUKSIT MONETAR
## (Metoda direkte)

| Nr. Ref. | Fluksi Monetar | Viti Ushtrimor | |
|---|---|---|---|
| | | 31 Dhjetor 2013 | 31 Dhjetor 2012 |
| I | | | |
| **1** | **Fluksi monetar nga veprimtaritë e shfrytëzimit** | ***464,441.74*** | ***(37,074.03)*** |
| a) | Parate e arkëtuara nga klientët | 1,703,846.07 | 604,577.30 |
| b) | Parate e paguara ndaj furnitorëve, punonjësve dhe taksa të # | (1,190,509.25) | (618,577.92) |
| c) | Parate e ardhura nga veprimtaritë | | |
| d) | Interesi i paguar | (895.08) | (156.41) |
| e) | Tatim mbi fitimin i paguar | (48,000.00) | (22,917.00) |
| | *MM neto nga veprimtaritë e shfrytëzimit* | *464,441.74* | *(37,074.03)* |
| **2** | **Fluksi monetar nga veprimtaritë investuese** | **2,039.67** | **(173,074.00)** |
| a) | Blerja e aktiveve afatgjata materiale | - | (173,074.00) |
| b) | Të ardhurat nga shitja e pajisjeve | - | - |
| c) | Interesi i arkëtuar | 2,039.67 | - |
| | *MM neto të përdorura në veprimtaritë investuese* | *2,039.67* | *(173,074.00)* |
| 3 | **Fluksi monetar nga aktivitetet financiare** | **-** | ***2,500,000.00*** |
| a) | Te ardhura personale Biznesi I Vogel | - | 2,500,000.00 |
| | *MM neto e përdorur në veprimtaritë financiare* | - | *2,500,000.00* |
| | | | |
| 4 | **Rritja/rënia neto e mjeteve monetare** | **466,481.41** | **2,289,851.97** |
| 5 | **Mjetet monetare në fillim të periudhës kontabël** | **2,289,851.97** | |
| 6 | **Mjetet monetare në fund të periudhës kontabël** | **2,756,333.38** | **2,289,851.97** |
| | | **2,756,333.38** | **2,289,851.97** |

# MAKAPAKA EXCHANGE

## SHENIME SHPJEGUESE

Mikronjesia EKONOMIKE "MAKAPAKA EXCHANGE" SH.P.K. i ka ndertuar Pasqyrat Financiare për vitin 2013 në bazë të Standardeve Kombëtare të Kontabilitetit dhe përkatësisht në mbështetje të plotë të SKK 15. Kjo është hera e pare që Mikronjesia i ndërton dhe i paraqet Pasqyrat Financiare sipas SKK në bazë të Ligjit nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për Kontabilitetitn dhe Pasqyrat Financiare", neni 4. Pasqyrat Financiare jane pergatitur duke ndjekur e zbatuar ***Politikat Kryesore Kontabel*** si : politika per njohjen e aktiveve, per njohjen e detyrimeve, njohjen e te drejtave, njohjen e te ardhurave e shpenzimeve si dhe vleresimin e tyre. Gjithashtu gjate pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane pasur parasysh ***Parimet*** informacionit: si Parimi i te drejtave dhe detyrimeve te konstatuara, Parimi i vijimesise se veprimtarise ekonomoke si dhe Parimi i Kompesimit. ***Karakteristikat*** cilesore te pergatitjes se Pasqyrave Financiare jane ato qe e bejne informacionin e pasqyrave financiare te dobishem per perdoruesin. Karakteristikat kryesore qe jane mbajtur parasysh gjate hartimit te Pasqyrave Financiare te vitit 2013 jane : Kuptueshmeria, Rendesia, Besueshmeria, Krahasueshmeria dhe Kompesimi.

## Përmbledhje e politikave kontabël

### Bazat e përgatitjes së pasqyrave financiare

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me ligjin shqiptar " Për kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" i ndryshuar, dhe me Standartet Kombëtare të Kontabilitetit. Ato janë përgatitur mbi bazën konceptit te materialitetit, bazuar ne supozimet-baze, parimet dhe karakteristikat e informacionit kontabel. Ato paraqiten në monedhën vendase, Lekë Shqiptar (lekë).

***Standartet Kombëtare të Kontabilitetit zbatohen për herë të dyte dhe aplikimi I tyre, sipas kërkesave të SNK-ve, është bërë në mënyrë perspektive***

*Në paraqitjen e pasqyrave financiare të vitit 2013 është zbatuar formati i SKK-15.*

***Parimet kontabile më domethënëse që janë përdorur nga shoqëria, janë si më poshtë:***

### Njohja e të ardhurave dhe shpenzimeve

Të ardhurat dhe shpenzimet njihen sipas kontabilitetit të të drejtave të konstatuara. Të ardhurat nga shitja e mallrave dhe produkteve njihen kur i janë kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet, maten me besueshmëri dhe ka siguri të mjaftueshme në marrjen e përfitimeve. Të ardhurat nga kryerja e shërbimeve njihen në varësi të fazës në të cilën ndodhet kryerja e shërbimit në datën e bilancit dhe të ardhurat dhe shpenzimet që lidhen me shërbimin mund të përllogaritet me besueshmëri. Të ardhurat vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme duke marrë parasysh shumën e skontimeve ose rabatet e ofruara. Shpenzimet njihen atëherë kur ato sigurohen prej të tretëve dhe në të njëjtin ushtrim kontabël me të ardhurat e lidhura.

### Monedhat e huaja

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në lek, me kursin zyrtar të këmbimit të Bankës në datën e kryerjes së transaksionit. Në cdo datë bilanci, zërat monetarë të bilancit të shprehur nëmonedhë të huaj rivlerësohen me kursin zyrtar të këmbimit në datën e bilancit. Zërat jomonetarë, të shprehur në monedhë

të huaj maten në termat e kostos historike dhe nuk rivlerësohen. Fitimi ose humbja e pa realizuar nga ndryshimi I kurseve të këmbimit njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit të përdorura nga shoqëria për monedhat e huaja më kryesore më 31.12.2013:

| Monedha | Viti 2013 | Viti 2012 | Ndryshimi |
|---|---|---|---|
| Euro | 140,20 | 139,59 | +0,61 |
| USD | 101,86 | 105,85 | -3,99 |
| GBP | 168,39 | 171,18 | +2,79 |
| CAD | 95,70 | 106,37 | -10,67 |

**Tatimin mbi fitimin**

Shpenzimi për tatimin mbi fitimin përfaqëson shumën e tatimit per tu paguar për vitin ushtrimor. Tatim fitimi I pagueshëm për vitin aktual bazohet mbi fitimin e tatueshëm I cili ndryshon nga fitimi tregëtar që raportohet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve sepse korrektohet nga shpenzimet e panjohura sipas legjislacionit fiskal. Norma aktuale e tatimit mbi fitimin për ushtrimin 2013 është 10 % .

**Kerkesat per t'u arketuar**

Kerkesat per t'u arketuar, te ardhurat e konstatuara dhe llogari te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u arketuar ne para regjistrohen ne bilanc me kosto te amortizuar. Kostoja e amortizuar e kerkesave per t'u arketuar afatshkurtra, ne pergjithesi eshte e barabarte me vleren e tyre nominale ( minus provizionet e krijuara per renie ne vlere), keshtu qe kerkesat afatshkurtra regjistrohen ne bilanc me vleren e tyre neto te realizueshme.

**Pasivet financiare**

Huat e marra, furnitorët, shpenzimet e konstatuara dhe huamarrje te tjera afatshkurtra dhe afatgjata, per t'u shlyer ne para, ne pergjithesi, mbahen me koston e amortizuar ne bilanc. Kostoja e amortizuar e pasiveve financiare afatshkurtra, ne pergjithesi, eshte e barabarte me vleren e tyre nominale; keshtu qe pasivet financiare afatshkurtra mbahen ne bilanc ne vleren e tyre neto te realizueshme.

**Aktivet Afatgjata Materiale**

Aktivet afatgjata materiale ( AAM-të ) bazohen në modelin e kostos. Në bilanc, një element I AAM-së paraqitet me kosto qe nenkupton cmimin e blerjes, perfshire detyrimet portuale dhe taksat e pakthyeshme si dhe cdo shpenzim tjeter te drejteperdrejte qe kryhet per sjelljen dhe vendosjen ne gjendje pune te ketyre aktiveve. Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material rritet, si rezultat I rivlerësimit, kjo rritje kreditohet drejtpërdrejt në kapitalet e veta nën zërin "tepricë nga rivlerësimi". Nëse vlera kontabël e një aktivi afatgjatë material zvogëlohet, si rezultat I rivlerësimit, ky zvogëlim njihet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve. Amortizimi është llogaritur mbi bazën e metodës lineare për ndërtesat dhe mbi bazën e vlerës së mbetur për pjesën tjetër të aktiveve të qëndrueshme. Normat e përdorura janë në ndërtesa 5% të vlerës mbetur dhe për aktivet e tjera 20% dhe 25% të vlerës së mbetur.

**Gjendjet e inventarët**

# MAKAPAKA EXCHANGE

Vlerësimi në hyrje i inventarëve bëhet me cmimet e blerjes dhe në rastet kur është e aplikueshme u shtohen kostot e shkaktuara për të sjellë inventarët në kushte magazinimi. Gjendjet e inventarit në pasqyrat financiare paraqiten me vleren me te vogel midis kostos dhe vleres neto te realizueshme.

**Ne vijim do të interpretojmë vlerat e paraqitura në pasqyrat përkatëse.**

**AKTIVET**

Bilanci Kontabël nis me Zeri I.1. *Aktive monetare* të cilat arrijnë në fund të vitit vlerën 2 756 333,39 leke. Zëri I.3. (c) paraqet vleren e *Kerkesave te tjera* per zero leke, Zeri I.4. (d) *Mallra per rishitje* qe i perket gjendjes se mallrave ne fund te periudhes eshte ne vleren 0 leke.

**Totali i Aktiveve Afatshkurtera per 2 756 333,39 leke**

***AKTIVET AFATGJATA***

Zeri II.5.(c) *Makineri e Paisje* perfaqeson vleren e mbetur te AQT(makineri e paisje e mjete transporti) nga vlera e blerjes eshte zbritur amartizimi deri ne fund te vitit 2013 per 138 459,20 leke.

**Totali i Aktiveve Afatgjata per 138 459,20 leke**

**AKTIVET TOTALI 2 894 792,59 leke**

**DETYRIMET DHE KAPITALI**

***DETYRIMET***

Zërin I.2.(a) *Te pagueshme ndaj furnitoreve* perfaqeson detyrimet e shoqerise ndaj furnitorëve per 0 leke te cilet jane të gjithë furnitorët ende te palikujduar deri në fund të vitit. Zeri I.2.(c) *Detyrime Tatimore* per 33 646,96 leke janë detyrimet e shoqerise per sigurimet shoqerore,tatim mbi pagat detyrime keto të muajit dhjetor të cilat do të likujdohen ne fillim te vitit pasardhës.

**Totali i Detyrimeve per 33 646,96 leke**

***KAPITALI***

Zeri III.1.*Kapitali i pronarit* në vlerën 2,500,000 leke. Zeri III.2.*Fitimi (Humbja) i vitit financiar* perfaqeson fitimin në vlerën (361 145,58 ) lekë e krijuar ne vitin 2012, dhe 2013.

**DETYRIMET DHE KAPITALI TOTALI 2 894 792,59 leke**

**TE ARDHURAT DHE SHPENZIMET**

Pasqyra e të Ardhurave dhe Shpenzime e ndërtuar sipas Natyrës, fillon me : Zëri I.1. *Shitjet neto* të cilat për vitin 2013 janë 1 703 846,07 lekë. Zeri II.1. *Shpenzimet per materialet* ne vleren (0) leke vjen si rezultat i

*Inventarit ne Celje* ne vleren (0) leke plus *Shpenzimet per mallrat* ne vleren (0) leke minus zeri *Inventari ne fund te vitit* ne vleren (0) leke. Zeri II.2. *Shpenzime personeli* për këto shitje arrin në vlerën prej (901 086) leke, nga te cilat për *pagat e punonjësve* (858 000) leke dhe për *sigurimet shoqërore* (43 086) leke që paguan njësia në emër të punonjësve. Zeri II.3. *Amortizime dhe zhvleresime* kemi vleren (34 614,80) leke qe

perfaqeson amortizimin e A.Q.T. ve per vitin ushtrimor . Zeri II.4. *Shpenzimeve të tjera per* (303 653,90) leke janë shpenzime qera, komisione bankare, mirembajtje, takse tabele dhe pastrimi dhe gjoba. Shpenzime Financiare (1 242,90) Zeri A. *Fitim apo humbja para tatimit* (Fitimi) per (464 491,37) leke perfaqeson diferencen e Te ardhurave nga shitja me shpenzimet direkte te ushtrimit.

***Për gjithë veprimtarinë e kryer gjatë viti korrent shoqëria ka shpenzuar për detyrim ndaj shtetit në formën e tatim fitimit per 48 232,96 leke.***

Nga krahasimi vlerave te mesiperme del *rezultati i vitit* fitim prej (417 501,31) leke, shifër e cila është e transferuar edhe ne bilancin kontabël në zërin përkatës te rezultatit te ushtrimit.

**REZULTATI I VITIT USHTRIMOR Fitimi (417 501,31) LEKE**

**HARTOI**
**Marsela BUSHI**
*(Financial Accounting)*

"STUDIO KONTABILITETI DHE AUDITIMI" BaEr Consulting Sh.p.k. TIRANE - ALBANIA

**Admistratori**
**Ergys Demneri**

MAKAPAKA EXCHANGE Sh.p.k. NIPT: L 21408005 P TIRANE - ALBANIA

# FORMULARI I URDHËR PAGESËS PËR DEKLARIMIN ELEKTRONIK TË TATIMIT MBI TË ARDHURAT PERSONALE TË BIZNESIT TË VOGEL

| Numri i Vendosjes se Dokumentit (NVD) |
|---|
| |

REPUBLIKA E SHQIPERISE MINISTRIA E FINANCAVE

| (2) Periudha Tatimore | (1) Numri Serial: | L21408005P3Y801Y |
|---|---|---|
| 2013 | | |

L21408005P3Y801Y

| | |
|---|---|
| **(3) Numri Identifikues i Personit të Tatueshëm (NIPT)** | L21408005P |
| **(4) Emri Tregtar i Personit të Tatueshëm** | MAKAPAKA EXCHANGE |
| **(5) Emri, Mbiemri, Personi Fizik** | |
| **(6) Adresa** | Rruga Bajram Curri, Pallatet 1 TIRANE |
| **(7) Numri i Telefonit:** | Tirane, Drejtoria Rajonale Tirane |

Data e deklarimit 2014-02-07

| **Në bazë të deklarimit tuaj shuma e mëposhtëme duhet paguar** | | |
|---|---|---|
| Totali për t'u paguar | | 233,00 |

**PAGESA**

Firma e Personit të tatueshëm:

Vetëm për Përdorim Zyrtar dhe plotësohet nga banka

- ◯ Lekë
- ◯ Xhirim
- ◯ Çek
- ◯ Të tjera

Shuma e paguar: 233

SOCIETE GENERALE ALBANIA 07.02.2014 TR2 A 0061

Data, Vula dhe Nënshkrimi i nëpunësit të bankës

Nr.P 3019092

Nr. Date

Nr.

DEFTESE
PER PRANIMIN E OBJEKTEVE ...

VULA DATARE

| | | | | |
|---|---|---|---|---|
| Objekti | Letra | Letr | Date | 08/02/2014 16:29:21 |
| KOD-BAR | RR494220257AA | | | |
| Dërguesi | MAKARAKA | | | |
| Marrësi | DREJTORIA RAJONALE TATIMORE | | | |

B1

| | |
|---|---|
| | 30 |
| | 30 |
| | 60 |
| | 120 |

RR494220255AA

Vula e Zyrës Pranuese të Lajmërimit

...y lajmerim - marrje do te kthehet
ne adresën time si më poshtë:

Plotësohet nga dërguesi
i cili duhet të tregojë drejtimin
e tij të plotë për kthimin
e këtij lajmërimi

Mod P6

Z. MAKARAKA
Rr. KAJO KARAFILI, Pall. Bimbashi, Ap 6/B, Kati 6
Tirana

# MAKAPAKA EXCHANGE SH.P.K.

**Tirane me:** 10 Korrik 2014

**Lenda :**Ju dergojme Vendimin e Asamblese se Ortakut te Vetem per Destinimin e Fitimit te Vitit 2013

**Drejtuar:** Qendres Kombetare te Rregjstrimit

Tirane

Drejtoria Rajonale Tatimeve

Tirane

Mbeshtetur ne Ligjin nr 9458 Dt . 21.12.2005 Per disa ndryshime dhe shtesa ne Ligjin Nr 8438 Date 28.12.1998 "Per Tatimin mbi te Ardhurat" te ndryshuar ,Ne mbeshtetje te neneve 78,83 pika 1 dhe 155 te Kushtetutes Neni 33/1 "Destinimi i Fitimit" pika 1 e 2 te ketij ligji bashkangjitur ju dergojme Vendimin e Asamblese se Ortakeve te Shoqerise " Per Rezultatet Financiare te vitit 2013."

**Administratori**

**ERGYS DEMNERI**

MAKAPAKA EXCHANGE Sh.p.k.
NIPT : L 21408005 P
TIRANE - ALBANIA

# MAKAPAKA EXCHANGE SH.P.K.

**Shoqeria "MAKAPAKA EXCHANGE" Sh.p.k.**
**Me kapital themeltar 2,500,000 Leke**
**Selia: Rruga BAJRAM CURRI, PALL.1 MAJI, SHK.4, TIRANE**
**Regjistruar ne NE QENDREN KOMBETARE TE REGJISTRIMIT**
**Dt. 08.02.2012**
**NIPT L 21408005 P**

Vendim Nr 1

I Asamblese se Pergjithshme te Zakonshme te Ortakut te Vetem te Shoqerise

Dt. 20 Qershor 2014

Sot me 20 Qershor 2014 ora 12 00 ,ne seline e Shoqerise u mblodh Asamblea e Pergjithshme e Zakonshme e Ortakut te Vetem te Shoqerise e thirrur nga Administratori dhe Ortaku z.Ergys Demneri.

Ne mbledhje jane te pranishem Ortaku:

- z. Ergys Demneri zoterues i 100 pjeseve ose 100 % te kapitalit te Shoqerise.

Ortaku perfaqeson teresisht pjeset e kapitalit themeltar te Shoqerise.

Asamblea eshte thirrur rregullisht dhe eshte e afte te marre vendime te vlefshme lidhur me rendin e dites si me poshte vijon:

1. Miratimin e raportit te Administratorit mbi Aktivitetin Ekonomiko – Financiar te Shoqerise per vitin 2013 dhe perspektivat per vitin 2014
2. Miratimin e Pasqyrave Financiare per vitin 2013
3. Caktimin e Rezultatit
4. Te tjera per te diskutuar

# MAKAPAKA EXCHANGE SH.P.K.

Pas diskutimit te ceshtjeve Asamblea e Ortakeve miraton me unanimitet vendimet e mesiperme e caktimin e fitimit si me poshte:

1. Rezultati -FITIMI -(mbas tatimit) e vitit ushtrimor 2013 eshte 361 145,25 leke
2. Fitimi do te perdoret per investime
3. Emerohet Shoqeria " A.A.P. " Sh.p.k. per auditimin ligjor te Pasqyrave Financiare per vitin 2014

Asamblea nuk ka ceshtje te tjera per te diskutuar.

Per sa u diskutua ne mbledhje u mbajt ky procesverbal i cili nenshkruhet nga pjesemarresit personalisht mbasi u lexua me ze te larte.

**PER ASAMBLENE E ORTAKEVE TE SHOQERISE**

**"MAKAPAKA EXCHANGE" Sh.p.k.**

**Ortaku**
**ERGYS DEMNERI**

MAKAPAKA EXCHANGE Sh.p.k.
NIPT : L 21408005 P
TIRANE - ALBANIA